

L I G J

Nr.8477, datë 22.4.1999

PËR DISASHTESADHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.7819,
DATË 27.4.1994 “PËR PRONËSINË INDUSTRIALE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7819, datë 27.4.1994 “Për pronësinë industriale”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 81, paragrafi i katërt ndryshohet si vijon:

“Në qoftë se kërkesa plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 78 të këtij ligji, Drejtoria e Patentave dhe Markave njofton me shkrim paraqitësin e kërkesës për pranimin për shqyrtim të kërkesës.”

Neni 2

Në nenin 82 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

- Paragrafi i tretë ndryshohet si vijon:

“Brenda një periudhe 5-mujore pas pranimit për shqyrtim të kërkesës, Drejtoria e Patentave dhe Markave, në përputhje me rezultatet e shqyrtimit miraton vendimin për regjistrimin e markës ose për refuzimin e regjistrimit dhe e publikon atë. Paraqitësi i kërkesës lajmërohet me shkrim për vendimin dhe, nëse vendimi është pozitiv, njoftohet për të paguar tarifën e regjistrimit dhe të publikimit të markës.”

Neni 3

Pas paragrafit të pestë shtohet paragrafi i gjashtë, me këtë përmbajtje:

“Në qoftë se paraqitësi i kërkesës bën pagesën e regjistrimit, menjëherë pas miratimit, në favor të vendimit që rezulton nga shqyrtimi, Drejtoria e Patentave dhe Markave regjistron markën në “Regjistrin e Markave” dhe publikon markën në gazetën e markave, gjithashtu i lëshon çertifikatën e regjistrimit të markës paraqitësit të kërkesës.”

Neni 4

Pas nenit 82 shtohet neni 82/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 82/1

Kundërshtimi i regjistrimit të markës

1. Kundërshtimi, në formë të shkruar, depozitohet në bordin e apelimit.